

AQUASHEILD PU



PËRSHKRIMI

AQUASHIELD PU është material hidroizolues i lëngshëm, njëkomponentësh, me bazë poliuretani. Fortësohet nga lagështia e ajrit dhe formon një shtresë filmi elastike dhe rezistente.

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Aplikohet lehtë me furçë, rul ose spërkatje.
- Formon një shtresë filmi të pandërprerë, pa fuga dhe pa pika rrjedhjeje.
- Është rezistent ndaj kontaktit të vazhdueshëm me ujin.
- Ruan vetitë mekanike ndërmjet -30°C dhe +90°C.
- Ka përshkueshmëri të mirë ndaj avullit të ujit. Falë strukturës që merr frymë, nuk shkakton grumbullim lagështie nën shtresë.
- Në rast dëmtimi, riparohet shpejt përsëri me AQUASHIELD PU.
- Ka rezistencë ndaj rrezeve UV.

REKOMANDIMET PËR PËRDORIM

- Terraca, veranda dhe ballkone,
- Ambiente të lagështa nën veshje (banjo, kuzhina etj.),
- Aplikime të brendshme dhe të jashtme,
- Kanale ujitëse,
- Membrana bituminoze,
- Panele gipsi dhe çimentoje,
- Çati të mbuluara.

TË DHËNA TEKNIKE

Lloji i veshjes	Poliuretan njëkomponentësh
Dendësia	1,45 ± 0,05 g/cm³
Viskoziteti	3.000–6.000 cP
Përshkueshmëria e avullit të ujit	0,8 g/m²-orë
Shkëlqimi	Gjysmëshkëlqim
Temperatura e aplikimit	+5°C deri në +35°C
Rezistenca ndaj nxehtësisë	100 ditë në +80°C
Rezistenca ndaj goditjes termike	200°C – E kaluar
Përmbajtja e lëndës së ngurtë	85% ± 5%
Fortësia	65 Shore A
Zgjatimi në këputje	>400%
Rezistenca në tërheqje në këputje	>5 N/mm²
Ngjitja në beton	>2 N/mm²
Rezistenca QUV	2.000 orë – E kaluar
Temperatura e shërbimit	-30°C deri në +90°C
Koha fillestare e tharjes	6 orë
Koha për aplikimin e shtresës pasuese	6–24 orë

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Para aplikimit, sipërfaqja duhet të pastrohet nga vajrat, yndyrat, mbetjet e parafinës, qumështi i çimentos, grimcat e lirshme, agjentët çlirues të kallëpeve, membranat e vjetra të kuruara dhe çdo faktor tjetër që dobëson aderimin dhe ngjitjen. Pas larjes me ujë me presion të lartë, sipërfaqja duhet të thahet plotësisht. Defektet e sipërfaqes duhet të riparohen me produkte të përshtatshme.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Para përdorimit, hapni ambalazhin dhe përziejeni produktin për 2-3 minuta me një përzierës me shpejtësi të ulët. Për hollimin, kontaktoni departamentin tonë teknik.

APLIKIMI

Produkti hidhet mbi sipërfaqen e astaruar dhe aplikohet me rul, shpatull gome ose furçë, në minimum 2 shtresa, derisa të mbulohet e gjithë sipërfaqja. Shtresa e dytë aplikohet minimumi 6 dhe maksimumi 24 orë pas shtresës së parë. Për të zgjatur rezistencën dhe jetëgjatësinë e hidroizolimeve me bazë poliuretani në sipërfaqe të pambuluara, të ekspozuara ndaj kushteve atmosferike ose trafikut këmbësor, sipërfaqja duhet të vishet me shtresën përfundimtare alifatike dhe elastike

PAKETIMI

Kanaçe 25kg

RUAJTJA

Produkti mund të ruhet maksimumi 12 muaj në ambalazhin origjinal, të pahapur, në temperatura nga +5°C deri +25°C. Produkti i hapur duhet të përdoret sa më shpejt.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Produkti duhet të përdoret në ambiente të ajrosura mirë. Nuk duhet të bjerë në kontakt me flakë të hapur dhe nuk duhet të pihet duhan gjatë aplikimit. Përdorni doreza mbrojtëse dhe maskë për mbrojtjen e duarve dhe syve. Në rast kontakti me sytë, shpëlajini menjëherë me shumë ujë. Gjatë aplikimit kërkohet ventilim i mjaftueshëm.

SHËNIME

- Rekomandohet që të shmangët aplikimi i produktit në temperatura nën 5°C.

